



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2031/9 prot.

Datë 15.09.2023

V E N D I M

Nr. 915/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 15.09.2023 me

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-74900-07-12-2023 me objekt “Prodhim, publikim dhe botim i materialeve për fushata promociionale”, me fond limit 1,684,360.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 24.07.2023, nga autoriteti kontraktor Bashkia Shkodër.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitura nga operatori ekonomik “Lulzim Mehmetaj”P.F., në procedurën e mësipërme e prokurimit.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Shkodër.
Adresa: Rruga “13 Dhjetori”, Nr.1 , Shkodër.

Ankimues: Operatori ekonomik “Inpress” SHPK me NIPT L52122014L dhe adresë: Rruga “Siri Kodra, ish blloku i magazinave tregtare, Tiranë.

Subjekte të Interesuar: Operatori ekonomik “Lulzim Mehmetaj” P.F me NIPT L36702001T dhe adresë:“ Rruga “Gjovalin Gjadri”, Zona Kadastrale nr.8593, nr. pasurie 13/264 , Shkodër.

Baza Ligjore: Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 13.07.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. me Nr. REF-74900-07-12-2023 me objekt “Prodhim, publikim dhe botim i materialeve për fushata promovionale”, me fond limit

1,684,360.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 24.07.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

II.2. Në datën 24.07.2023, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 04.08.2023 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

“Lulzim Mehmetaj” P.F	1,051,100 lekë	Kualifikuar
“Shkodra Design” SHPK	1,518,860 lekë	Skualifikuar
“Inpress” SHPK	1,679,000 lekë	Skualifikuar

II.4. Në datën 15.08.2023, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim Fituesi paraprak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, ku për këtë procedurë prokurimi është shpallur fituese oferta e operatorit ekonomik “Lulzim Mehmetaj” P.F.

II.5. Operatori ekonomik ankimues “Inpress” SHPK rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit për arsyet si më poshtë: *“Shtojca 9, Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit ,Seksioni B, Deklarata për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura, është plotësuar gabim pasi është deklaruar një operator tjetër ekonomik. -DEKLARATA “Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura” dhe DEKLARATA “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës” nuk është sipas formatit të DST. Pasi ka përmbajtje të ndryshme nga ajo e përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit -Ne mostrat e paraqitura ditën e hapjes së ofertave mungon mostra e flamurit. -Keni paraqitur skeletin në formatin 3m lartësi X 80cm gjerësi por me bazament hekuri dhe jo plastik me mbushje me ujë siç kërkohet në specifikime teknike. - Stilolapsa me logo nuk është në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor pasi nuk është metalike”.*

II.5.1. Në datën 21.08.2023, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2023/3376 dhe me nr. 2031 prot., datë 21.08.2023 i operatorit ekonomik “Inpress” SHPK, lidhur me skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit objekt-ankimi dhe kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Lulzim Mehmetaj” P.F. duke argumentuar: *“Për sa i përket vendimit të KVO të AK, për Skualifikimin e Operatorit Ekonomik “Inpress” shpk., Ju paraqesim kundërshtitë tona si vijon:*

AK Bashkia Shkodër ka skualifikuar OE Inpress shpk. për arsyet e mëposhtme:
a) Shtojca 9, Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, Seksioni B, Deklarata për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura, është plotësuar gabim pasi është deklaruar një operator tjetër ekonomik.
b) DEKLARATA “Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura” dhe DEKLARATA “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës” nuk është sipas formatit të DST. Pasi ka përmbajtje të ndryshme nga ajo e përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit

c)Ne mostrat e paraqitura ditën e hapjes së ofertave mungon mostra e flamurit.
- Keni paraqitur skeletin në formatin 3m lartësi X 80cm gjeresi por me bazament hekuri dhe jo plastik me mbushje me ujë sic kerkohet në specifikime teknike. - Stilolapsa me logo nuk është në përputhje me specifikimet teknike të kerkuara nga Autoriteti Kontraktor pasi nuk është metalike."

1. Përsa i përket arsyes së parë të skualifikimit të OE Inpress shpk.: "a) Shtojca 9, Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit, Seksioni B, Deklarata për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura, është plotësuar gabim pasi është deklaruar një operator tjetër ekonomik.", do të donim të parashtronim sa mëposhtë vijon: Përmendja e emrit të një subjekti tjetër tregtar në Shtojcën 9, Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit, Seksioni B, Deklarata për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura, është thjesht një "lapsus", në plotësimin e tij, i cili vjen si rrjedhojë e plotësimit të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit mbi një Formular të mëparshëm Vetëdeklarimi, në një procedurë tjetër prokuruese, ku OE Inpress shpk. ka marrë pjesë si bashkim operatorësh ekonomikë me subjektin tregtar të cituar gabimisht në këtë Formular, i cili nuk ka asnjë lidhje me procedurën prokuruese në rastin tonë konkret. Këtu do të donim të theksonim se përmendja gabimisht, në formën e një "lapsusi", të një subjekti tjetër tregtar, nuk e bën kurrësesi Formularin Përmbledhës së Vetëdeklarimit të OE Inpress shpk. të pavlefshëm. Maksimumi ky "lapsus" mund të konsiderohet si një "devijim i vogël", i cili nuk mund ta bëjë ofertën ekonomike të OE Inpress shpk. të pavlefshme. Në po të njejtin Formular Përmbledhës Vetëdeklarimi emri i operatorit ekonomik pjesëmarrës Inpress shpk. &shë përmendur me dhjetra herë të tjera. Rrjedhimisht nuk ekziston asnjë dyshim apo paqartësi që në rastin konkret bëhet fjalë thjesht për një "lapsus" të parëndësishëm. Përsa mësipër, në lidhje me këtë pikë, në përputhje me dispozitat ligjore dhe nenligjore të prokurimit publik... KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik "KPP", do të duhet të konsiderojë të vlefshme dhe të pranueshme ofertën ekonomike të paraqitur nga operatori ekonomik "Inpress" shpk., duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.

2. Përsa i përket arsyes së dytë të skualifikimit të OE Inpress shpk.: "b) DEKLARATA "Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura" dhe DEKLARATA "Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës nuk është sipas formatit të DST. Pasi ka përmbajtur të ndryshme nga ajo e përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit do të donim të parashtronim sa mëposhtë vijon: Kjo arsye e parashtruar nga KVO e AK Bashkia Shkodër nuk qëndron, pasi Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, dhe konkretisht DEKLARATA "Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura" dhe DEKLARATA "Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës", janë plotësuar ekzaktesisht dhe identikisht (gërmë për gërmë dhe presie për presie) sipas Shtojcës 9, të përcaktuar në DST e procedurës së prokurimit. Përsa i përket kësaj arsye skualifikimi të përdorur nga KVO e AK, do të donim të shtonim gjithashtu se, verifikimi nëse Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit i dorëzuar nga OE Inpress shpk. është në përputhje me Shtojcën 9 të DST, është mjaft i thjeshtë, pasi kemi të bëjmë me një situatë faktike, e cila lë pak vend për diskutime të mëtejshme. Ky Formular Vetëdeklarimi është dorëzuar në sistemin SPE të APP dhe kushdo mund ta verifikojë lehtësisht, Për sa më sipër, edhe në lidhje me këtë pikë, në përputhje me dispozitat ligjore dhe nenligjore të prokurimit publik... KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik "KPP", do të duhet të konsiderojë të vlefshme dhe të pranueshme ofertën ekonomike të paraqitur nga operatori ekonomik "Inpress" shpk., duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.

3. Përsa i përket arsyes së tretë të skualifikimit të OE Inpress shpk.: -Ne mostrat e paraqitura ditën e hapjes se ofertave mungon mostra e flamurit. - Keni paraqitur skeletin në formatin 3m lartesi X 80cm gjeresi, por me bazament hekuri dhe jo plastik me mbushje me ujë sic kerkohet ne specifikime teknike. Stilolapsa me logo nuk eshte ne perputhje me specifikimet teknike te kerkuara nga Autoriteti Kontraktor pasi nuk eshte metalike." do të donim të parashtronim sa më poshtë vijon: Në pikën 2.3.6. "Kapaciteti Teknik", të shtojcës 8, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të DST, përcaktohet se:"2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostra për artikujt e kërkuar, sipas listës me poshte:Drejtoria e Turizmit

1-Çanta cope; 2-Flamuj promocional; 3-Guida; 4-Blllok A5 me logo;;5-Poster forex

Drejtoria e Kultures, Arsimit, Rinise dhe Sportit

1-Baner;2-Kupe;

Drejtoria e Sherbimeve Sociale,Strehimit dhe Shendetit Publik

1-Rool-Up; 2-Canta doku; 3-Stilolapsa te personalizuar

Dorëzimi i mostrave të bëhet ditën dhe oren e hapjes së tenderit prane Zyres se Protokollit Bashkia Shkoder, ato duhet të jenë të mbyllura në një zarf/kuti jo transparente të vulosur. Së bashku me mostrat, ofertuesi duhet të bëjë shoqërimin e mostrave me një shkresë të firmosur nga përfaqesuesi ligjor dhe vulosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti. Mosparaqitja e mostrave është kusht skualifikim.

Shënim: Në lidhje me mostrat e kërkuara, nuk është e domosdoshme që të bëhen me logon e Bashkise Shkoder por pranohen edhe me një logo tjetër të çfarëdoshme" Në përputhje të plotë me këtë kriter kualifikues të përcaktuar në DST, ditën dhe orën e hapjes OE Inpress shpk. paraqiti mostra të ngjashme për secilin artikull sipas listës së sipërcituar, për të cilën është mbajtur rregullisht edhe procesverbali i dorëzimit të tyre.

Së pari, Përsa i përket arsyes së përdorur nga KVO e AK për skualifikimin e OE Inpress shpk.: "-Ne mostrat e paraqitura ditën e hapjes se ofertave mungon mostra e flamurit.", do të donim të theksonim se kjo arsye nuk është aspak e vërtetë, pasi OE Inpress shpk. ditën dhe orën e hapjes së ofertave ka paraqitur një flamur nga një punë e ngjashme e mëparshme e realizuar nga OE Inpress shpk., me logon e Bashkisë Tiranë. Siç parashtruar më sipër, edhe për dorëzimin e këtij artikulli është mbajtur rregullisht procesverbali i dorëzimit, i nënshkruar nga përfaqësues të Bashkisë Shkodër dhe OE Inpress shpk. Nga ana tjetër, nuk kuptohet se si OE Inpress shpk. ka dorëzuar skeletin por nuk a dorëzuar flamurin në vetvete Këtu do të donim të shtonim se, edhe në këtë rast, kemi të bëjmë me një situatë tërësisht faktike, e cila mund të verifikohet lehtësisht nga KSHA e AK dhe KPP.

Së Dytë, Përsa i përket arsyes së përdorur nga KVO e AK për skualifikimin e OE Inpress shpk.: "- Keni paraqitur skeletin në formatin 3m lartesi X 80cm gjeresi por me bazament hekuri dhe jo plastik me mbushje me ujë sic kerkohet ne specifikime teknike.", do të donim të parashtronim se: Në pikën 2.3.6. "Kapaciteti Teknik", të shtojcës 8, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të DST, NUK përcaktohet me asnjë vend se mostrat e dorëzuara do të duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike. Në këtë pikë të DST përcaktohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës do të duhet të dorëzojnë "...mostra të ngjashme sipas listës...", por nuk cittohet në asnjë gjermë të kësaj pike që këto mostra do të duhet të jenë në përputhje të plotë me specifikimet teknike të përcaktuara në DST. Rrjedhimisht, bazuar në dispozitat ligjore dhe nënligjore të prokurimit publik, një operator ekonomik pjesëmarrës nuk mund të skualifikohet nga një procedurë prokuruese, bazuar në kritere teknike të cilat nuk ekzistojnë. Dhe në rastin konkret, kriteri që

përdor KVO e AK si arsye për skualifikimin e OE Inpress shpk. "...mostra do të duhet të jetë në përputhje të plotë me specifikimet teknike të përcaktuara në DST..." NUK EKZISTON. Pavarësisht sa më sipër, këtu do të donim të theksonim gjithashtu se, mostra e ngjashme e dorëzuar nga OE Inpress shpk. "Flamur Promocional", është shumë më cilësore se ky artikull i kërkuar në specifikimet teknike të përcaktuara në DST. Rrjedhimisht, KVO e AK nuk mund të skualifikojë OE Inpress shpk. me arsyetimin se ka sjellë një mall më cilësor se ai i kërkuar në specifikimet teknike të përcaktuara në DST.

Se Treti, Përsa i përket arsyes së përdorur nga KVO e AK për skualifikimin e OE Inpress shpk.: "Stilolapsa me logo nuk është në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor pasi nuk është metalike.", do të donim të parashtronim se: Edhe në këtë rast, vlen arsyetimi i lartpërmendur. Në pikën 2.3.6. "Kapaciteti Teknik", të shtojcës 8, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të DST, NUK përcaktohet me asnjë vend se mostrat e dorëzuara do të duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike. Në këtë pikë të DST përcaktohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës do të duhet të dorëzojnë "...mostra të ngjashme sipas listës...", por nuk citohet në asnjë gjë të kësaj pike që këto mostra do të duhet të jenë në përputhje të plotë me specifikimet teknike të përcaktuara në DST. Rrjedhimisht, bazuar në dispozitat ligjore dhe nënligjore të prokurimit publik, një operator ekonomik pjesëmarrës nuk mund të skualifikohet nga një procedurë prokuruese, bazuar në kriteret teknike të cilat nuk ekzistojnë. Dhe në rastin konkret, kriteri që përdor KVO e AK si arsye për skualifikimin e OE Inpress shpk. "...mostra do të duhet të jetë në përputhje të plotë me specifikimet teknike të përcaktuara në DST..." NUK EKZISTON. Për sa më sipër, edhe në lidhje me këtë pikë, në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore të prokurimit publik.....KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik "KPP", do të duhet të konsiderojë të vlefshme dhe të pranueshme ofertën ekonomike të paraqitur nga operatori ekonomik "Inpress" shpk., duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.

Përsa i përket vendimit të KVO të AK, për Kualifikimin e Operatorit Ekonomik "Lulzim Mehmetaj" Ju paraqesim kundërshtitë tona si vijon:

Së pari, Operatori ekonomik "Lulzim Mehmetaj", ka paraqitur një ofertë ekonomike tërësisht dhe anomalisht të ulët. Fondi limit i përcaktuar në DST për këtë procedurë prokurimi është 1,684,360 (një milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e katërmijë e treqind e gjashtëdhjetë) Lekë pa TVSH. Oferta ekonomike e paraqitur nga operatori ekonomik "Lulzim Mehmetaj" është në vlerën e 1,051,100 (një milion e pesëdhjetë e njëmijë e njëqind) Lekë pa TVSH. Thënë ndryshe kjo ofertë është 38% (tridhjetë e tetë për qind) më e ulët se vlera e fondit limit. Do të mjaftonin këto vlera / shifra, që oferta ekonomike e paraqitur nga OE Lulzim Mehmetaj të konsiderohej anomalisht e ulët nga AK Bashkia Shkodër, dhe rrjedhimisht ky operator ekonomik të skualifikohej nga kjo procedurë prokuruese. Në zbatim të nenit 93, pika 1, të Ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik"; dhe nenit 82, pika 4 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke iu referuar procedurës prokuruese të lartpërmendur, kjo ofertë do të duhet të konsiderohet i) anomalisht e ulët, dhe si rrjedhojë të konsiderohejt ii) e papranueshme nga AK. Më poshtë Ju parashtrojmë në mënyrë të detajuar se ky operator ekonomik, bazuar në çmimet për njësi të ofertuara, dhe vlerës totale të ofertuar NUK arrin të realizojë furnizimin me mallrat/artikujt dhe shërbimet e kërkuara nga DST për këtë procedurë

të prokurimit publik. Në nenin 93, pika 1 dhe 2, të LPP që përcakton se: 1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë. 2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për: a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit; b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës; c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi; ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës; d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore." Në përputhje me nenin 93, pika 1, të LPP, OE Lulzim Mehmetaj do të duhet të japë në mënyrë të detajuar shpjegimet në lidhje me: a) Anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit; b) Zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës; c) Origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi; pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës; d) Mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore: Vetëm pasi, OE të ketë dhënë në mënyrë të detajuar shpjegimet për secilën prej shtyllave të lartpërmendura, duke sqaruar në mënyrë shteruese arsyet teknike dhe mundësinë e realizueshmërinë së kontratës (duke mos rrezikuar kështu realizimin e kontratës), bazuar në vlerën e ofertuar prej tij, atëherë AK do të mund të vlerësonte nëse kjo ofertë ekonomike mund të konsiderohet ose jo e pranueshme, duke mos rrezikuar kështu për asnjë moment realizimin e kontratës. Referuar nenit 93, pika 1, të LPP, bazuar në sasitë dhe specifikimet teknike të mallrave, nisur edhe nga eksperiencia dhe ekspertiza e padiskutueshme e stafit teknik të specializuar të OE Inpress shpk., e cila është ndër shoqëritë e rëndësishme, që operon në tregun shqiptar për prodhimin dhe furnizimin e artikujve / produkteve promocionalë të përcaktuara në DST, do të donim t'ju theksonim se OE Lulzim Mehmetaj e ka të pamundur teknikisht të prodhojë dhe furnizojë autoritetin kontraktor me mallrat e kërkuara (sipas specifikimeve, cilësisë dhe sasive të përcaktuara në DST) në vlerën e ofertuar prej tij, dhe rrjedhimisht e ka të pamundur të realizojë me sukses kontratën e prokuruar, për arsyet e mëposhtme: i) Fillimisht do të donim t'ju informonim se procesi i prodhimit të produkteve / artikujve të promocionalë është kompleks, ku ekzistojnë një sërë faktorësh, të cilët diktojnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë koston e prodhimit, dhe si rrjedhojë çmimet e ofruara. Zërat kryesorë të kostove që ndikojnë drejtëpërdrejtë në procesin e prodhimit janë: i) Kosto e lëndëve dhe materialeve të para; ii) Kosto e punës (orët punës) e stafit teknik dhe administrativ; iii) Shpenzimet e përgjithshme administrative, etj.

ii) Bazuar në elementët teknikë të lartpërmendur, bazuar gjithashtu në sasitë dhe specifikimet teknike të mallrave të kërkuara në DST, nga përlllogaritja e bërë nga stafi teknik i specializuar i OE Inpress shpk, vetëm KOSTO e lëndëve të para dhe e prodhimit të këtyre mallrave është shumë herë më e lartë se vetë oferta ekonomike e paraqitur nga OE Lulzim Mehmetaj. Nuk kuptohet se si ky OE do të mund të realizojë këtë kontratë prokurore, dhe pa e rrezikuar atë, ku vetëm Kosto e lëndëve të para dhe e prodhimit është shumë herë në e lartë se Oferta Ekonomike e paraqitur...???

Siç mund të vërehet lehtësisht, produktet / mallrat e kërkuara nga DST, nuk mund të prodhohen / realizohen nga OE Lulzim Mehmetaj, duke marrë për bazë vetëm koston e lendeve të para dhe 18 prodhimet të tyre. Këtu do të donim të theksonim gjithashtu, që në këtë analizë, nuk është marrë parasysh asnjë marzh fitimi (pra marzhi i fitimit është konsideruar "0"), Fakt ky, i cili është bën teorikisht dhe ekonomikisht të pamundur realizimin e këtyre produkteve.

iv) Këtu e gjejmë me vend të nënvizojmë faktin se OE Lulzim Mehmetaj nuk ka as eksperiencën dhe as ekspertizën e nevojshme të furnizimit me mallrat promovionale të përcaktuar në DST
v) Rrjedhimisht, ky OE nuk mund të realizojë këtë kontratë prokuruese, dhe pa e rrezikuar atë, pasi oferta ekonomike e paraqitur nga ky operator ekonomik është tërësisht anomalisht e ulët, por edhe nga fakti se ky operator ekonomik nuk gëzon / ka asnjë zgjidhje teknike / kusht favorizues, apo ndonjë origjinalitet, me anë të së cilës të ishte i favorizuar kundrejt operatorëve të tjerë ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokuruese,... përkundrazi OE Lulzim Mehmetaj nuk ka as eksperiencën dhe as ekspertizën e nevojshme të furnizimit me mallrat promovionale të përcaktuar në DST. Fakt ky, i cili është bën teorikisht dhe ekonomikisht të pamundur furnizimin e AK me këto produkte dhe vendos seriozisht në rrezik realizimin e kontratës objekt i kësaj ankese
vi) Bazuar në faktet e lartpërmendura, OE Lulzim Mehmetaj do të duhet, në përputhje me nenin 93, pika 1, të LPP-së, të provojë / vërtetojë qartësisht përpara AK, se çfarë veçorish dhe teknologjisht inovative / alternative ka / përdor OE Lulzim Mehmetaj, të cilat e mundësojnë atë, që bazuar në vlerën e ofertuar, jo vetëm përballon të gjitha kostot e prodhimit dhe furnizimit të mallrave, por edhe të ketë një marzh minimal fitimi, duke mos rrezikuar kështu për asnjë moment realizimin e kontratës. Bazuar në njohuritë, informacionet dhe eksperiencat tona të tregut të prodhimit dhe furnizimit të mallrave / artikujve promovionale në Republikën e Shqipërisë, OE Lulzim Mehmetaj, nuk ka asnjë veçori apo aftësi teknologjike inovative / alternative në raport me operatorët e tjerë ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokuruese, përkundrazi nuk ka as eksperiencën dhe as ekspertizën e nevojshme për këtë qëllim. Përsa më sipër, në përputhje me dispozitat ligjore dhe nenligjore të lartpërmendura... ..KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik "KPP", do të duhet të konsiderojë të pavlefshme dhe të papranueshme ofertën ekonomike të paraqitur nga operatori ekonomik Lulzim Mehmetaj, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.

Së Dyti, Në kundërshtim me pikën 2.3.6. "Kapacitetet teknik", të shtojcës 8, "Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të DST, OE Lulzim Mehmetaj nuk ka paraqitur mostrat e ngjashme të kërkuara në DST, për disa nga artikujt. Në pikën 2.3.6. "Kapaciteti Teknik", të shtojcës 8, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të DST, përcaktohet se: "2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostra për artikujt e kërkuar, sipas listës me poshte; Drejtoria e Turizmit 1-Çanta cope; 2-Flamuj promovional; 3-Guida; 4-Bllok A5 me logo;;5-Poster forex

Drejtoria e Kultures, Arsimit, Rinise dhe Sportit

1-Baner;2-Kupe;

Drejtoria e Sherbimeve Sociale, Strehimit dhe Shendetit Publik

1-Rool-Up; 2-Canta doku; 3-Stilolapsa të personalizuar

Dorëzimi i mostrave të bëhet ditën dhe orën e hapjes së tenderit pranë Zyres së Protokollit Bashkia Shkoder, ato duhet të jenë të mbyllura në një zarf/kuti jo transparente të vulosur. Së bashku me mostrat, ofertuesi duhet të bëjë shoqërimin e mostrave me një shkresë të firmosur nga përfaqësuesi ligjor dhe vulosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti. Mosparaqitja e mostrave është kusht skualifikim.

***Shënim:** Në lidhje me mostrat e kërkuara, nuk është e domosdoshme që të bëhen me logon e Bashkise Shkoder por pranohen edhe me një logo tjetër të çfarëdoshme" Ditën dhe orën e hapjes së ofertave Operatori Ekonomik Lulzim Mehmetaj, është paraqitur për të dorëzuar mostrat pranë protokollit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkodër. Mostrat ishin në një kuti të vogël jeshile me përmasa jo më të mëdha se 40x50x30 cm. Në lidhje me këtë kriter kualifikues, duke qenë se ditën dhe orën e hapjes së ofertave OE Lulzim Mehmetaj është paraqitur me një kuti të vogël e cila mbahej lehtësisht në dorë, fakt i cili tregon qartazi që ky OE nuk i ka paraqitur të gjithë mostrat e kërkuara në DST, ne kemi bindjen që Lulzim Mehmetaj nuk ka paraqitur mostrat e kërkuara në DST, si më poshtë: Flamuj promocional; Poster forex; Kupe; Rool-Up....pasi nuk ekziston mundësia fizike që në një kuti me ato përmasa, të vendosen mostrat e lartpërmendura. Konkretisht: 1. Mekanizmi i Roll Up-it materiali i të cilit është i papërthyeshem, metalik dhe nuk ekziston në treg një format më i vogël se 80x100 cm - është i pamundur të futet në një kuti me përmasa jo më të mëdha se 40x50x30 cm;*

2. Mekanizmi i flamurit promocional, prej 3 m i cili dhe nëse do të ndahej në pjesë nuk mund të vendoset në një kuti të vogël dhe është i pamundur të futet në një kuti me përmasa jo më të mëdha se 40x50x30 cm;

3. Posteri Forex i cili në DST parashikohej 100x150 cm - është gjithashtu i pamundur të futet në një kuti me përmasa jo më të mëdha se 40x50x30 cm;;

4. Artikulli Kupë, në rast se në atë kuti do të jenë vendosur artikujt e tjerë si baner, guida, çanta cope, çanta doku, bllok A5 me logo, stilolapsa të personalizuar, nuk do të mund të kishte hapësirë edhe për vendosjen e këtij artikulli është i pamundur të futet në një kuti me përmasa lo më të mëdha se 40x50x30 cm: Rrjedhimisht nuk ekziston mundësia fizike dhe faktike, që OE Lulzim Mehmetaj të ketë paraqitur të gjithë mostrat e kërkuara në DST. Për sa më sipër, në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore të prokurimit publik... ..KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik "KPP", do të duhet të konsiderojë të pavlefshme dhe të papranueshme ofertën ekonomike të paraqitur nga operatori ekonomik "Lulzim Mehmetaj" ShPK., duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.

***Së Treti,** Mendojmë që në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në DST, dhe rregullat e prokurimit publik, OE Lulzim Mehmetaj, ditën dhe orën e hapjes së ofertave, ka pasur detyrime tatimore të papaguara dhe kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të papaguara. Për këtë arsye, kërkojmë nga KSHA e AK dhe KPP, që përpara marrjes së një vendimi të arsyetuar për sa i përket kësaj pike, të kërkojnë zyrtarisht një informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.*

Gjithashtu, mendojmë që OE Lulzim Mehmetaj, nuk ka paraqitur / dorëzuar në sistemin SPE të APP, një Vërtetim të vlefshëm, i cili vërteton shlyerjen e të gjitha detyrimeve të faturave të energjisë elektrike, në përputhje me rregullat e prokurimit publik. Rrjedhimisht, OE Lulzim Mehmetaj, do të duhet të skualifikohet pasi nuk plotëson kriteret e përcaktuara në DST dhe në rregullat e prokurimit publik. Për të gjitha sa u parashtruan më sipër, kërkojmë nga KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik: Ndryshimin e Vendimit të KVO të AK, duke e konsideruar si të plotë dhe të rregullt ofertën ekonomike të paraqitur nga OE Inpress ShPK., duke e kualifikuar atë; Ndryshimin e Vendimit të KVO të AK, duke e skualifikuar ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik Lulzim

Mehmetaj; Shpalljen fitues të procedurës së prokurimit të lartpërmendur, operatorin ekonomik "Inpress" ShPK.

II.5.1. Në përputhje me nenin 112 "Veprimet paraprake" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.2031/2 prot, datë 22.08.2023, korrigjuar me formularin nr.2031/4 prot., datë 29.08.2023, lidhur me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimes "Inpres" SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit dhe kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik "Lulzim Mehmetaj" P.F.

II.5.2. Me anë të shkresës Nr.12020 prot., datë 29.08.2023, protokolluar pranë institucionit tonë me Nr.2031/5 prot., datë 01.09.2023, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacion në lidhje me procedurën e mësipërme të prokurimit si dhe informacion mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes "Inpress" SHPK, nga ku rezulton, se autoriteti kontraktor nuk e ka pranuar atë.

II.5.3. Me shkresën me nr. 2031/6 prot., datë 07.09.2023 me objekt: "*Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik Inpress SHPK*", Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi autoritetit kontraktor informacion si vijon: "*[...] Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimes "Inpress" SHPK si dhe me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik "Lulzim Mehmetaj" P.F. në procedurën e mësipërme të prokurimit.*

Në datën 01.09.2023 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 2031/5 prot., shkresa e autoritetit tuaj kontraktor me nr.12020 prot., datë 29.08.2023 me objekt: "Informacion". Nga shqyrtimi i informacionit dhe dokumentacionit bashkëngjitur kësaj shkrese, Komisioni i Prokurimit Publik nuk mund të gjykojë mbi hapat e ndjekura nga KVO-ja për trajtimin e ofertës anomalisht të ulët të operatorit ekonomik "Lulzim Mehmetaj" P.F. dhe mbi dokumentacionin e paraqitur për justifikimin e ofertës së tij ekonomike.

Për sa më sipër, me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës pranë KPP-së, në përputhje me nenin 115 të LPP-së, autoriteti kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, informacion të hollësishëm mbi hapat e ndjekura nga KVO-ja për trajtimin e ofertës anomalisht të ulët të operatorit ekonomik "Lulzim Mehmetaj" P.F si dhe dokumentacionin e plotë të paraqitur nga ky operator ekonomik për të justifikuar ofertën e tij ekonomike, e cila ka rezultuar anomalisht e ulët.

Po ashtu, në pikën 6 të nenit 26 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit", të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, ligjvënësi ka parashikuar se "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të

dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Sa më sipër, me qëllim vijimin e gjyqimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ju lutem të paraqisni pranë KPP-së, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja dijani e kësaj shkrese, dokumentacionin e plotë në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin, të dorëzuar pranë autoritetit tuaj kontraktor, nga operatori ekonomik “Lulzim Mehmetaj” P.F., sa i takon plotësimin të kriterit të kualifikimit të përcaktuar në shtojcën 8, Kriteret të Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit, pika 1/dh dhe pika 1/e.

Gjithashtu, krahas informacionit të mësipërm, KPP kërkon nga autoriteti juaj të dorëzoni pranë institucionit tonë mostrat e paraqitura për këtë procedurë prokurimi, nga operatori ekonomik “Lulzim Mehmetaj” P.F dhe operatori ekonomik “Inpress” SHPK, së bashku me dokumentacionin shoqërues të tyre, si dhe procesverbalin e mbajtur nga autoriteti kontraktor për administrimin e tyre”.

II.5.4. Me shkresën nr. 12534 prot., datë 11.09.2023, protokolluar me tonën me nr. 2031/7 prot., datë 12.09.2023 është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, “Autorizim”, në bazë të të cilit z. Ermal Dizdari, specialist pranë njësisë së prokurimit, Bashkia Shkodër, ka dorëzuar pranë ambienteve të KPP, mostrat e paraqitura nga operatorët ekonomikë “Inpress” SH.P.K. dhe “Lulzim Mehmetaj” P.F., shoqëruar me dokumentacionin që këta dy operatorë ekonomikë kanë paraqitur ditën e tenderit.

II.5.5. Në datën 13.09.2023 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 2031/8 prot., shkresa e autoritetit kontraktor me nr.12533 prot., datë 11.09.2023 me objekt: “Informacion.”, bashkëngjitur së cilës gjendej dokumentacioni i kërkuar me shkresën tonë Nr.2031/6 prot., datë 07.09.2023, e më konkretisht:

- 1. Procesverbalet e mbajtura nga KVO në lidhje me shqyrtimin e ofertës anomalisht të ulët dhe të dokumentacionit shoqërues sjellë nga operatori ekonomik Lulzim Mehmetaj Person Fizik për justifikimin e ofertës anomalisht të ulët.*
- 2. Dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik Lulzim Mehmetaj Person Fizik në plotësim të kriterit kualifikues pika 1/dh dhe pika 1/e sipas VKM nr.285 datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publiku ndryshuar, neni 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”.*
- 3. Procesverbalet e mbajtura nga KVO mbi shqyrtimin e mostrave të paraqitura nga ofertuesit “Inpress” sh.p.k dhe “Lulzim Mehmetaj” Person Fizik. (Gjithësej 65 fletë).*

II.6. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e autoritetit kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të tjera të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, në zbatim të nenit 29, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, në të cilin parashikohet se “1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përgjithësisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre”, referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që shqyrtimi i mëtejshëm i ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK ka lidhje me veprimet e tjera të autoritetit kontraktor, gjatë zbatimit të hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

III.1.1. Marrë shkas nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Inpress” SHPK, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar pranë KPP-së, konkretisht procesverbalit nr. 3 “Për verifikimin e mostrave të mallit të operatorit ekonomik Inpress ShPK”, me Nr. 9658/3 prot., datë 27.07.2023 dhe procesverbalit nr. 4 “Për verifikimin e mostrave të mallit të operatorit ekonomik Lulzim Mehmetaj p.f.”, me Nr.9658/7 prot., datë 27.07.2023, përcjellë me anë të shkresës me objekt “*Informacion*”, me nr. 12533 prot., datë 11.09.2023, protokolluar me tonën me nr. 2031/8 prot., datë 13.09.2023”, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se mostrat e paraqitura nga ana e operatorëve ekonomikë ofertues për këtë procedurë prokurimi janë administruar nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, por procesverbalet e mbajtura, për administrimin e mostrave të dorëzuara, nuk janë nënshkruar nga të dyja palët (përfaqësuesit e autoritetit kontraktor dhe përfaqësuesi i ofertuesit).

III.1.2. Në nenin 2 “*Qëllimi*” të ligjit nr.162/2022 “*Për Prokurimin Publik*” parashikohet se:

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.3. Neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “*Për Prokurimin Publik*” parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe

judiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.4. Udhëzimit nr. 03, datë 12.04.2022 “Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomikë” pika 3 parashikon se: *“Për të dokumentuar procesin e administrimit të mostrave, autoriteti/enti kontraktor duhet të mbajë procesverbale, me qëllim sigurimin e transparencës dhe integritetit të këtij procesi. Në këtë kuptim, në rast kur autoriteti/enti kontraktor vlerëson si të nevojshëm dorëzimin e mostrave, në datën dhe orën e përcaktuar në dokumentet e tenderit për paraqitjen e tyre nga ofertuesit, duhet të mbajë një procesverbal,. Procesverbali duhet të dokumentojë procesin e paraqitjes së mostrave, si dhe duhet të pasqyrojë detaje që përshkruajnë mostrën/at e administruara. Në këtë rast, mbajtja e procesverbaleve i shërben vetëm procesit të paraqitjes së mostrave, deri në momentin e kthimit të tyre tek ofertuesit. Procesverbali i mbajtur me ofertuesin/ofertuesit e pranishëm, i cili duhet të nënshkruhet nga të dyja palët (përfaqësuesi/it i autoritetit/entit kontraktor dhe i ofertuesit/ve), duhet t’i vihet në dispozicion ofertuesit/ve. Në rast se, ndonjëra nga palët ka komente/pretendime, ato duhet të pasqyrohen në procesverbalin e mbajtur”.*

III.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik, sa më sipër analizuar, gjykon, se autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit, është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit dhe hapat që duhet të ndiqen për përzgjedhjen e ofertës më të mirë, në kuptim të këtij ligji. KPP konstaton, se duke u kthyer tek ankesa e paraqitur në lidhje me vlerësimin e procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, një nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues ”Inpress” SHPK, ka të bëjë përkatësisht me mospërmbushjen e specifikimeve teknike të artikujve ...” *Në mostrat e paraqitura ditën e hapjes se ofertave mungon mostra e flamurit.*

- Keni paraqitur skeletin në formatin 3m lartësi X 80cm gjerësi, por me bazament hekuri dhe jo plastik me mbushje me ujë siç kërkohet ne specifikime teknike. - Stilolapsa me logo nuk është në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor pasi nuk është metalike.”, të procedurës së prokurimit objekt-ankimi nga ana e operatorit ekonomik ankimues.

III.1.6. Për sa më sipër, bazuar në faktet dhe informacionin e depozituar, Komisioni i Prokurimit Publik vëren parregullsi procedurale lidhur me ekzaminimin e mostrave nga autoriteti kontraktor, pasi referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ, rezulton, se procesverbalet e mbajtura për administrimin e mostrave janë të njëanshme. Në këtë rast, veprimet procedurale të ndjekura nga autoriteti kontraktor lidhur me ekzaminimin e

mostrave (në rastin konkret artikujt *Çanta, Flamuj promocional, Guida, Bllok A5 me logo, Poster forex, Baner, Kupe, Rool-Up, Çanta doku, Stilolapsa te personalizuar*) të padokumentuara përmes një procesverbali të rregullt, nuk janë transparente dhe në çdo rast mund të krijojnë dyshime lidhur me prezencën fizike dhe saktësinë e mostrave të cilat do të shërbenin më pas për ekzaminim të mëtejshëm dhe rrjedhimisht për shqyrtimin e pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues.

Po ashtu, referuar pretendimit të operatorit ekonomik ankimues " - *OE Inpress shpk. ditën dhe orën e hapjes së ofertave ka paraqitur një flamur nga një punë e ngjashme e mëparshme e realizuar nga OE Inpress shpk., me logon e Bashkisë Tiranë, në lidhje me arsyen e skualifikimit se,Në mostrat e paraqitura ditën e hapjes së ofertave mungon mostra e flamurit*", KPP konstaton, se autoriteti kontraktor nuk ka treguar kujdesin e duhur në lidhje me ruajtjen dhe administrimin e mostrave, konfirmuar ky fakt nga procesverbali i njëanshëm i mbajtur nga anëtarët e KVO për administrimin e mostrave.

KPP gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma "dh", se qëllimi i ligjit të prokurimit publik është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces.

III.1.7. Sa më sipër, mungesa e transparencës lidhur me hapat proceduralë të ndjekur nga autoriteti kontraktor, për sa i përket verifikimit të mostrave, shkel parimin e mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, nxitjes së konkurrencës dhe pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit, dhe krijon hapësirë për vlerësim subjektiv.

KPP nënvizon, se në respekt të parimit të transparencës, mosdiskriminimit dhe barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve që u ngarkohen ofertuesve, jo vetëm kriteret e kualifikimit, por edhe procedurat verifikuese të ndjekura nga autoriteti kontraktor duhet të jenë të qarta, të sakta dhe të mirëpërcaktuara nga autoriteti kontraktor, me qëllim që të jenë sa më të kuptueshme dhe transparente, jo vetëm për operatorët ekonomikë të interesuar për të qenë pjesëmarrës, por edhe për komisionin e vlerësimit të ofertave dhe komisionin e shqyrtimit të ankesave, në mënyrë të tillë, që procesi i vlerësimit të kryhet në transparencë të plotë dhe jo me subjektivizëm, si dhe të vendosë në situatë të barabartë të gjithë ofertuesit, duke rritur besimin e subjekteve në një procedurë prokurimi. KPP sqaron, se ndër qëllimet kryesore të ligjit të prokurimit publik është edhe ai i sigurimit të integritetit, besimit të publikut dhe transparencës në zhvillimin e procedurave të prokurimit.

III.1.8. Në nenin 118, pika 2, gërma "b" të Ligjit nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", sipas të cilit: "*Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; nenin 98, pika 1, gërma "d" të këtij ligji përcaktohet shprehimisht: "Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj".*

Në nenin 45, pika 1 gërma “b” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: “[...]Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të veprimtarisë së shqyrtimit të ankesave para lidhjes së kontratës procedon me: b) Vendim për pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit/entit kontraktor, që të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” [...]”. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se procesi i administrimit, trajtimit dhe verifikimit të mostrave është bërë jo në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik, pasi mungojnë dy elemente të rëndësishme, transparenca dhe provueshmëria, ndaj, përbën shkak për anulimin e procedurës së prokurimit, me qëllim trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë. Në këto kushte, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë parashikimet e këtij vendimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranohet ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik Inpress” SHPK për procedurën e prokurimit në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-74900-07-12-2023 me objekt “Prodhim, publikim dhe botim i materialeve për fushata promovionale”, me fond limit 1,684,360.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 24.07.2023 nga autoriteti kontraktor Bashkia Shkodër.
2. Autoriteti kontraktor të anulohet procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi dhe akteve pjesë e dosjes të shqyrtimit administrativ i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri